

VENDIM
Nr. 643, datë 19.9.2012

**PËR DHURIMIN E NJË SASIE ARMATIMI, KONTRIBUT I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR NGRITJEN
E MUZEUT TË LUFTËS SË UÇK-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimin qeverisë së Republikës së Kosovës të një sasive armatimi jashtë nevojave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si kontribut i qeverisë shqiptare, me qëllim ngritjen e Muzeut të Luftës së UÇK-së.

2. Lloji dhe sasia e armatimit që do të dhurohet është sipas listës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha